



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 36, datë 26.03.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GREAT RING ROCK"
GODINË BANIMI DHE SHËRBI MI ME 30 KATE MBI TOKË DHE 4 KATE
NËNTOKË", ME VENDNDODHJE PRANË RRUGËS "TEODOR KEKO", BASHKIA
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "Albus Invest" sh.p.k dhe "Loraldo" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Great Ring Rock", Godinë banimi dhe shërbimi me 30 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë, me vendndodhje pranë Rrugës "Teodor Keko", Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë "Albus Invest" sh.p.k dhe "Loraldo" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 04, datë 27.11.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Great Ring Rock" Godinë banimi dhe shërbimi me 30 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë", me vendndodhje pranë Rrugës "Teodor Keko", Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë "Albus Invest" sh.p.k dhe "Loraldo" sh.p.k., shfuqizohet.



5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 17/02/2026